

NERTILA KËLLIÇI GOGA

E FOLMJA E TIRANËS NËN NDIKIMIN E VAZHDUESHËM TË SHQIPES STANDARDE

Gati gjysmë shekulli më parë u vendos standardizimi i shqipes, si një proces i natyrshëm dhe i domosdoshëm i kohës, në një stad të caktuar të zhvillimit historik, politik, ekonomik e shoqëror të Shqipërisë, në momentet kur u ndje nevoja për të krijuar një variant standard të gjuhës për komunikim në rrafshin kombëtar. Kjo formë e gjuhës, rezultat i punës kolosale të studiuesve të saj, bashkimit të pikëpamjeve dhe marrjes së vendimeve të përbashkëta për elementët leksikorë e fjalëformues, për dukuritë fonetike, morfologjike e sintaksore, për drejtshkrimin e drejtshqiptimin e shqipes, etj., është sot ajo mbi të cilën bazohen të gjitha komunikimet zyrtare e shoqërore shqiptare.

Në këto 25 vite të ndryshimeve të mëdha që Tirana ka pësuar, sidomos ato politike e sociale, urbanizimi të përshpejtuar e imigrimi njerëzor në rritje të vazhdueshme, një atmosfere të tejperfshirë me dialekte, të folme, huazime e terminologji të huaja, padyshim që solli me vete edhe një gjuhë të folur të ditëve të sotme shumë të ndryshme nga ajo e dikurshme e kryeqytetit. Nëse dikur forma kryesore e të folurës së kryeqytetasve ishte si një marrëdhënie e ndërsjellë mes gjuhës letrare dhe të folmes së Tiranës, ku të bënte shumë përshtypje tek dëgjoje të të kalonte afër ndokush me të folurën në dialekt të pastër të jugut apo të veriut, sot shqipja që të kap veshi nëpër Tiranë duket e copëzuar dhe disi e ngatërruar në tingull e përmbajtje, dëgjon kudo të folme nga të gjitha qytetet, qytezat e fshatrat shqiptare, ku normat drejtshkrimore e drejtshqiptimore të gjuhës shfaqen në bashkëjetesë të rrëmujshme me trajtat e ndryshme të dialekteve apo ato disi të zbehura të të folmeve. Në thelb, qëmtimi dhe integrimi i larmisë leksikore në pasuri kombëtare, do të ishte një proces i dobishëm gjuhësor, në një kohë kur shqipja standarde, megjithëse nuk ka kaluar shumë kohë që është formësuar, është ndeshur me prirje të guximshme studimesh për ta ndryshuar atë.

Përballë një situatë shoqërore e gjuhësore kaq të ndryshueshme, e folmja që duket se po ndikohet më shumë, është e folmja e Tiranës. Në një kryeqytet që po shfaq luhajtje të mëdha në shqipen e folur publike, brenda së cilës kjo e folme po përpiket të rezistojë, është objekt i analizës së këtij punimi.

Qyteti i Tiranës ka historinë e tij, traditat, zakonet, karakteristikat që e veçojnë atë nga zona të tjera të vendit, e sidomos, format e veçanta të të shprehurit, tipike të grupit të të folmeve të gegërishtes jugperëndimore. Në këtë punim, për të të nxjerrë në pah gjendjen e sotme të gjuhës së tiranasve të

vjetër, të folmes së banorëve autoktonë tiranas, janë zhvilluar bashkëbisedime me 41 persona, të lindur e rritur në Tiranë, me origjinë të vjetër tiranase, për të vërejtur në mënyrë krahasuese të folmen e tre brezave, si dhe për të parë ndryshimet e kësaj të folmeje mes gjeneratash¹. Pra, në punim janë konsideruar me emërtimin ‘brez i parë’ kryefamiljarët e intervistuar të moshave 70 - 80 vjeç (20 veta, që të gjithë të njohur për origjinën e tyre familjare prej 5, 6 apo 7 brezash në Tiranë), ‘brez i dytë’ 30 - 50 vjeçarët (12 veta, disa prej të cilëve fëmijë të të sipërpërmendurve) dhe ‘brez i tretë’ 15 - 24 vjeçarët (9 veta, tre prej të cilëve mbesë e nipër të brezit të parë). Vlen të përmendet se për të vëzhguar se deri në ç’masë e përdorin të folmen tipike tiranase, të intervistuarit janë pyetur kryesisht për historinë e familjeve prej nga vijnë, për jetën e tyre, punësimin apo shkollimin, pa u treguar qëllimin e vërtetë të intervistës, në mënyrë që të mos kufizoheshin në formën e tyre të zakonshme të të folurit të shqipes. Më poshtë janë renditur përmbledhtazi disa nga tiparet më karakteristike gjuhësore që vërehen sot tek e folmja e këtyre tiranasve *denbabaden*.

Vëzhgim mbi të folmen e Tiranës. Disa tipare fonetike, morfologjike e sintaksore.

Tipari i parë gjuhësor dhe më i veçantë që të kap menjëherë veshi e që të tërheq vëmendjen tek të gjitha bashkëbisedimet, tek të tre brezat, edhe kur fjalitë janë të sakta nga pikëpamja e gjuhës standarde, është tipari fonetik, mënyra e të shqiptuarit të fjalëve, si p.sh. në rastet kur fonemat zanore janë të theksuara dhe të zgjatura: *rru:g, fu:sh, çu:n, bu:rr, mo:ll, zako:n, ba:r, dja:l, fja:l, e:r, mi:r*, etj. Ndërsa në rastet e përdorimit të zanores *a* të theksuar që del si *ô* hundore: *kurôn, tirônas, dhônri, kôm, kom bô/môr, me dhôn, nxônës, amon, për t’bo*, etj., apo të përdorimit të zanores *a* të patheksuar si *o* e anasjelltas: *gamori, damotja, aborri*, etj., tek brezi i parë këto procese fonetike janë mjaft karakteristike, tek brezi i dytë hasen më pak, dhe tek brezi i tretë, pak ose aspak.

Hundorësia e zanoreve është tipari tjetër po aq i veçantë i kësaj të folmeje, që vërehet më tepër tek më të vjetrit tiranas, siç është kalimi i tingullit hundor *â* në *ô* dhe ruajtja e *n*-së ndërzanore në vend të *r*-së: *gjôna* (gjëra), *vuna* (vura), *pruna* (prura), *lene* (lëre), *pasunia* (pasuria), *vena* (vera), etj.

Në bashkëbisedimet me të tre brezat është tepër e dukshme rënia e zanores *ë* të patheksuar, në rrokje fundore që mbyllet nga bashkëtingëllore, shpesh jo

¹ Shënim: Bashkëbiseduesit janë nga familje 300-400 vjeçare tiranase (ndër ta vetëm 3 gra), kryesisht me arsim të lartë, dhe të familjeve: Tafaj, Luga, Demneri, Rreli, Alimehmeti, Ndroqi, Bimbashi, Cenoymeri, Heta, Këlliçi, Fagu, Shijaku, Llozi, Qinami, Harasani, Topi, Toptani, Shushku, Vorpsi, Llagami, Saraçi, Mulleti, Tafalla, Nishku, Janku, Hobdari, Begeja, Konçi, Murthi, Sallaku, Mema, Tabaku, Bogdani, Karapici, Stërmasi, Ferra (disa nga të fundit me arsim të mesëm). Nuk janë paraqitur emrat e personave me të cilët është kryer bashkëbisedimi për të ruajtur privatësinë e tyre.

sonante, fenomen që ndodh kryesisht edhe tek ata që flasin rrjedhshëm shqipen standarde. P.sh. mungesa e mbaresës ë në trajtën e shquar shumës të emrave mashkullorë: *shokt, miqt, robt, punt*, po kështu dhe ë-ja e temës në trajtën e shquar njëjës të disa emrave femërorë: *dits, gocs, drits*. Në të folmen e Tiranës, kryesisht tek brezi i parë dhe i dytë, mungesa e zanores ë në trup a në fund të fjalës haset rëndom edhe tek foljet: *vrej* (vërej), *vijn* (vijjë), *mson* (mëson), *kput* (këput), etj.

Një dukuri tjetër e rëndësishme e tipike për këtë të folme dhe që ndeshet më shumë tek më të vjetrit e intervistuar, ca më rrallë tek fëmijët e tyre, dhe aspak tek mbesat a nipërit, është kur grupi *tj* kalon në tingullin qiellzor *q*: *qeglla* (tjegulla), *qetër* (tjetër), po kështu edhe kur togjet e zanoreve kalojnë në zanoreve të thjeshta: *ie>i*, *ye>y*,: *mill* (miell), *fyll* (fyell), *dill* (diell), *qill* (qiell), etj.

Prirja për shkurtim të fjalëve gjatë shqiptimit, eliminim të një apo më shumë bashkëtingëlloreve apo zanoreve në fillim, në trup e në fund të fjalës, është një tjetër tipar dallues që haset shpesh në të folmen e Tiranës, sidomos tek brezi i parë dhe i dytë, si p.sh: *mrapa* (mbrapa), *kshu* (kështu), *knej* (këndej), *nryshoj* (ndryshoj), *nodh* (ndodh), *katnar* (katundar), *msus* (mësues), *luj* (luaj), *du* (dua), *e maj men* (e mbaj mend), *me nru* (me ndërru), *fillun* (filluan), *myllet* (mbyllet), *mar* (mbarë), *i qut/i squt* (i zgjuar), *kadal-kadal* (ngadalë-ngadalë), etj.

Ndërkaq theksi duket se është në përpjekje të vazhdueshme për përshtatje, gjë që ta kap veshi edhe gjatë bisedave me brezin e parë. Ndërsa sa u përket fjalëve me prejardhje nga turqishtja, ndryshe nga ç'ndodh tek të folmet e toskërishtes, që ruajnë ende theksin origjinal të mjaft turqizmeve, tek e folmja e bashkëbiseduesve tiranas, ato duken të ngulitura mirë me theksin e sotëm gjuhësor: *káfe, tenxhére, penxhére*, etj.

Në këndvështrimin morfologjik, tek të intervistuarit e brezit të dytë dhe të tretë vihet re një humbje e dukshme e përdorimit të përemrave vetorë (veta I, II, njëjës): *un(ë), ti*, në trajtat e dikurshme *una, tina*, ndryshe nga ç'ndodh tek bashkëbiseduesit e brezit të parë. Po kështu, edhe sa u përket përemrave pronorë: *im, ime, tat, tate* (çuni *im* - çuni *tat*, goca *ime* - goca *tate*); apo foljeve të parregullta *jam, kam* dalin *jom – jina, kom – kina* (veta I, II, shumës), si dhe tek forma foljore *t'thomi* (të themi).

Tek familjet tiranase prej shumë gjeneratash, sidomos në rastet kur brezi i parë dhe i dytë kanë bashkëshortë tiranas autoktonë, shfaqet në mënyrë të dukshme përdorimi i trajtave foljore pa mbaresën *n* në vetën II dhe III njëjës, si p.sh. ti *lexo(n)*, ai *lexo(n)*, ti *vepro(n)*, ai *vepro(n)*, etj., në fjali të tilla si: Ti *puno* te Ministria? Ajo *m(ë)so* shumë. Po *kërko* punë? Ku *jeto* tani?

Ndërsa tek të gjithë kryeqytetasit e rinj të lindur e rritur në Tiranë, dëgjohen papushim forma tingullore apo shprehje të ndeshura rëndom tek e folmja e 'tironëve' e tipit: *ho mo, ho mi, hë mo, hë mi*, etj.

Në vitet '60, personaliteti i gjuhësisë, prof. Çabej, në një studim të tij, do të vërente shfaqjen e *a*-së te shumësi i emrave mashkullorë, që, do ta shpjegonte “të shkaktuar kryesisht nga nevoja për një karakterizim më të theksuar të shumësit”², si p.sh.: *msusa, profesora, avukata*, etj. Ndërkohë që sot, dëgjohet jo pak përdorimi i mbaresës *o* në fund të emrave: *msuso, profesoro, avokato*, etj., karakteristikë kjo kryesisht tek dy brezat më të rinj.

Përdorimi i parafjalës *më/m'* në vend të *në/n'*, që tregon marrëdhënie kohore apo vendore, vihet re ende tek dy brezat më të mëdhenj: *m'Tiron, m'shpi, m'qoshet, m'kraharror, m'nëndor'*, apo të variantit *ene* në vend të lidhëzës *edhe*, që shfaqet më së shumti tek më të vjetrit tiranas: *bojeni ene ju, duli ene ai qetri, me qit ene kalamonin*, etj.

Gjithashtu, format e mëposhtme të përdorimit të foljeve janë ndeshur më tepër tek bisedat e zhvilluara me brezin e parë, më rrallë me brezin e dytë (përgjithësisht tek ata me arsim të ulët) dhe thuajse aspak tek më të rinjtë:

- ndërtimi i foljeve në të pakryerën, duke shtuar tek mbaresa bashkëtingëlloret *j* dhe *sh*: veta I, njëjës - punoj**sha**; veta II, njëjës - punoj**she**; veta III, njëjës - punoj**te**; veta I, shumës - punoj**shim**; veta II, shumës - punoj**shit**; veta III, shumës - punoj**shin**.

- ndërtimi i formave të tjera kryesore foljore për të shprehur kohën e ardhme: *do + lidhore*, ku pjesëza të thuajse gjithnjë shqiptohet pa zanoren ë: *do t'mor, do t'boj, do t'thomi*, etj.;

- forma *kam + paskajore*: *kam/kom për t'bo, kom për t'mor; me + pjesore*: *kam/kom me harxhu, kam/kom me votu, kam/kom me mor vesh*; etj.;

- format foljore: *jam, kam + përcjellore*, në vend të pjesëzës duke del gjerësisht *tu*, si në kohën e tashme ashtu dhe në të pakryerën, p.sh.: *jom tu lexu, isha tu lexu; jom tu bo, isha tu bo*, (në mjaft raste, këto forma, për nga konteksti i përkasin formës së të tashmes, ku *tu* zëvendëson pjesëzën *po*: *jom tu lexu* - po lexoj, *jom tu gatu* - po gatua, *jom tu la durët* - po laj duart, etj.).

- përdorimi i paskajores së tipit *me punue*, e cila përdoret rregullisht pas foljeve të tipit: *zë, filloj, nis, hyj*, p.sh.: *zu: me fol, me harru; ene fillu:n me punu; nisi me shkru:jt, hyni me bisedu;*, ku dallohet ndryshimi në temë i foljes *me nxjerr*, që në të folmen e Tiranës shpesh del në formën: *me qit*; si dhe në disa raste, me foljen ndihmëse *mund* apo *duhet*: *s'munda me ik, s'duhet me shku*, dhe më rrallë *s'mujta me ik*, etj.

- përdorimi i formës foljore *do + me + pjesore, duhet + me + lidhore*, apo *di + me + pjesore*: *do me shku; do me maru pu:n, u:n s'di me vu: firm*, etj.

- varianti i të kryerës së thjeshtë ku zanorja *o* shndërrohet në *u*: *duli (doli), muri (mori)*, etj.

- forma e lidhores: *t'mori* (të marrë), etj.

Disa tipare leksikore

² E. Çabej (1963), *Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe*, III, f. 75.

Në këtë drejtim, në të folmen e Tiranës sot, gjatë bashkëbisedimeve të realizuara u shfaqën dendur fjalët e mëposhtme tek brezi i parë:

- foljet: *çel* (ose hap), *mrrij* (mbërrij), *nroj* (ndërroj), *shof* (shoh), *cys* (nxis, ngacmoj);

- emrat: *safi* (i pastër, i kulluar), *dryn* (çelës), *katun* (katund), *kuron* (kuran), *kuron* (kurore), *tomël* (qumësht), *pras* (presh), *tlyn* (gjalp), *daci* (maçoku), *komça* (kopsa), *gore* (bushtër), *damote* (domate), *capu* (sapuni), *katrahurë* (rrëmujë), *hyçkla* (pretekst, kleçkë), *llāpa* (gjuha);

- ndajfoljet: *ke* (tek), *ka* (nga), *dro* (ndoshta), *knei* (këtej), *cipër* (sipër), *anej* (andej), *nai/noi* (ndonjë), *halā* (akoma), *bidevi* (drejt), *kun* (kërrkund);

- mbiemrat: *zybë* (i trashë); *teveqel* (i metë);

- nyja: *nji/i* (një);

- përemri lidhor: *qi* (që), përemri pyetës: *çer* (çfarë),

- pasthirrmat e shprehjet: *ho* (hë); *mo, me* (moj, more), *hë/ho mo, ho me, ho mre, mer jahu*;

- si dhe fjalët, një pjesë e të cilave përdoren dendur sot edhe nga ata që s'kanë origjinë të vjetër familjare tiranase, siç janë turqizmat: *hiç, nejsë, vallaj, penxhere, sepet, alamet, safi, takat, sabahu, millet, shinjoll, bismilah, kadaif, pite, shishqebap*, etj.

Ndërkaq, shprehjet apo fjalët e rralla në të cilat përfshihen shprehje popullore e frazeologjike të të folmes së qytetit të Tiranës, u hasën në bisedat e kryera vetëm me brezin e parë. Brezi i dytë i kishte të njohura, por nuk i përdorte, ndërsa tek brezi i tretë pak prej tyre ua dinin kuptimin: *jepi kon ksaj pune* - jepi zgjidhje; *llap* - flet shumë; *kput nai mufkë* - flet gjëra bosh, kot; *s'kam niet* - s'kam kohë, s'kam ndërmend; *s't'bo njeri ner badjava sot* - s'të bën njeri nder falas sot; *me mur avdes* - të lash duart, fytyrën dhe këmbët përpara se të falesh; *i hunt ene i litarit* - i shkathët; *t'i kesh n'shinjoll* - t'i kesh në mendjen tënde; *me bo bismilah* - në emër të Zotit; *shko xhinsi ke xhinsi* - i ngjan racës prej nga vjen; *mund t'i ket nodh nai gjosen qi s'ka ardh* - mund t'i ketë ndodhur diçka që s'ka ardhur; *kon dal m'sherit* - kanë dalë në qytet; *ça re keni bo?* - ç'kemi? si jeni? *çar i thash mer?* - çfarë i thashë more? *ça bohet mor kshu* - çfarë bëhet kështu; *s'u date ka shpia* - nuk u ndante (largonte) nga shtëpia; *kini për t'i pa hajrin* - keni për t'ia parë të mirën; etj.

Në vijim janë pasqyruar pjesë historish të treguara nga gratë me të cilat janë zhvilluar bisedat, që të treja rreth moshave 70-80 vjeç, ku vetëm njëra ka qenë edukatore, të tjerat shtëpiake. Bie në sy e folura e tyre thuajse tërësisht në të folmen tipike të Tiranës:

- *Jom martu ke Xhamia Tabakve, mi ka ble mobiljet burri, mobiljet e mija ishin n'valut, shkopin me dorez florini, një çun ke Pezt i pat bo, e njof mir, kemi nejt afër, ka qen i asllon i modh. Kom pas ene i sepet t'bukur fort, por m'osht prish mo, ka koha. Me dimiq jom vesh, ene kom la fotot, me kartoshina, nga ato qi kon qen me bo fotot. Kena pas naplona 20 frangshe. Ene sa hy ke*

shpija, shof burrin, i bukri dheut mo. Kena kalu mir, ka dek i ri mo, ene i kom rrit vet kalamojt, e harroj mo na iher. Vallaj, mu m'kon dhon i kuron (kuran) t'bukur fort si dhurat, e kom ene sot e s'e xjer prej shpije asier.

- E kom njoft, me thon t'drejtën, kom pas respekt për at çun, me bab e non shum t'mir, rob t'mir, mos ardht mo ajo koh, o zot qi je m'qill, kshu kon qen mo, me t'mor prej shpije, i sajojshin mi gjonat, e t'rrasnin mrena. Maj men njonin e murën ene e kon shalu m'hu veç se po imitojte grun e një prej ktyne t'mdhejvet, e hajshe kot m'si koti mo n'at koh. Tashi gjonat jon nryshe, a ta mur menja qi do bohej kshu? T'gjitha i kom lexu ene i lexoj mjes per mjes.

- Pa i zot, t'gjitha i pagu n'kët bot, s'ka çajre goce, t'i kesh n'shinjoll kto qi po t'them, e qi thu ti, s'di me fol mir una, jom me pak klas shkoll, po s'nigjoi gruja shpisë me bo bismilah (në emër të zotit), s'hec shpija. T'tre çunat i kom m'Itali, marshallah, t'martum, t'rregullum, t'rehatum. Ene ne pleqt, s'dulim shum n'dill, rrina n'shpi, shnet dum, asigjo qetër. T'falemnens shum.

Më poshtë janë dhënë disa pjesë të shkëputura nga bisedat me meshkujt e brezit të parë:

- Kemi nejt ke Selvia, para se me shku ke Medresja në nontqint e tremdhjetën, ke rruga ton, na kon vu i kunj t'modh, çerdhja osht bo n'trullin tim, e ka m'dor një nga personat më me zo n'Tiron, kupto? Nuk kom shku me e njëk me thon t'drejtën.

- E flas si mbje rasti, ene gruja ime e flet m'shpi shum, tironse vjetër ne ajo mo, ene kalamojt e flasin ka iher n'shpi, n'rrug jo, nuk e flasim, flasim standardin. Kemi jetu mir, ne tironsit, kemi shku mir mo, ne muhamedanët, kshu i thojshnin dikur myslimonve, me llacifact, domethon, me vlleht, me ortodokst. Neve u kena pas thon llacifac, domethon që flisin shum, llafe-llafe, por nuk është e vërtet. Jan njerz shum t'mir e siç thash, kena shku shum mir.

- Kur kan dash me na zaptu, ne kena kontribu, luftu, si fis kena qen remtarë, qi punojshin bakrin. Stërgjyshi tem boni kishn e vjetër, por kena shku mir me myslimont, hanim ene ne iftarë, ene për syfyr, i kom jetu vet kto punë, pranej i di kto t'dhona, ene Shën Vasilin, se kshu i thojshim për Vitn e ri, e bojshim bashkë, u bojte nga t'gjithë. Jom ktu për me tregu qi ene një prej nesh, shkoi n'haxhillëk e u bo haxhi n'Mekë, e masnej një vlla i tates tem u bo një nga tregtari qi furnizonte të gjithë tironsit me sapu, mill, oriz.

- Nigjova ca zhurma t'çuditshme mren ke shpia, e kishte myll penxheren, ç'bohet kshu mer sot, goca huj qi gërthiste, ta gadis un ty, i thojte ai, goca teme qi rrite aty n'fun t'dhoms, m'u dukte sikur ishte n'shpi teme mi, ço ky kshuna mi, una ktu m'shpi teme, ti gërthet me zo t'nalt. Fillun t'hapshin dyrët komshijt, ene erdh policia masanej. U tmerrum n'fillim, por jena msu tashi me lloj-lloj robsh qi vin ktuna m'Tiron. Për zot'n e modh, qi s'kena mor vesh ça kishte bo vaki dje, veç kur e mura vesh prej televizorit, tak dul lajmi, masnej duli ene ai qetri, m'ka një fiksim me thon t'drejtën, na flliqën mi, mos njëjt tiron m'kom po vazhdun kshuna robt.

Ndërsa në vijim janë pjesëza të bisedave të zhvilluara me meshkujt e femrat e brezit të dytë:

- *Jena familje tironsisht denbabaden, që me ç'më ka tregu baba, kan luftu në koh t'Luftës Dyt Botrore, dhe megjithëse kan qen t'varfër, prap e kan majt kokën lart. Edhe nonën e kom tironse t'vjetër. Ngaiher m'duket se nona e flet më shum se baba t'folmen tipike t'tironsve. Vet jam i shkollum, i martum e me fëmij. Tironsit e dun shkollimin, edhe jo vetëm unë, por ene motrat e mia jan me shkollë. Do përpiqem që dhe fëmijet e mi të shkollohen e t'bëhen t'mbarë n'jet.*

- *Me thon t'drejtën, ndihem krenar që jam tiron i vjetër, s'e di pse, por ja, më vjen keq që katurarët që vijn përditë n'Tiron, sikur po ia humbasin vlerat qytetit. Nuk flas gjuhën tipike tironçe, se dhe baba im pak e flet. Ai është me shkollë të lartë, tani në pension, por edhe xhajat e s'e kan fol. Gjyshërit kanë vdek kur kam qen i vogël e kam dëgjuar nga çunat e xhajës që jan më t'mdhenj se un, që ata kan pas fol tamam si tek 'Qazim Mulleti'. Do kisha dash shum t'i kisha njoft e t'mësoja prej tyre shumë fjalë t'vjetra të tironsve.*

- *Babai im është me origjinë tiranase 300 e ca vjeçare, sipas pemës gjenealogjike të familjes, që e kam parë vet. Kur flet im atë me fjalë tipike tironse, mua ma shpif, s'e di pse s'më pëlqen, dua që të flasë si unë, normalisht, e kupton shumë më lehtë se unë të folmen e pleqve që flasin atë tipiken, ndërsa mami im është me origjinë nga jugu, por çuditërisht dhe asaj sikur i del ndonjë fjalë në të folmen e tiransve, e unë e ngacmoj për këtë.*

Nga sa më sipër, rezultoi se:

- Më të moshuarit e brezit të parë flisnin thujse çdo fjalë në të folmen tipike të Tiranës. Pra, tiparet dialektore të kësaj të folmeje të gegërishtes jugperëndimore ishin ende të ruajtura mirë në gojën e tyre. Kjo gjë ishte më tepër e dukshme tek personat me arsim të paktë, të cilëve shumë rrallë u qëllon të bien në kontakt me standardin, tek gratë më shumë se sa tek burrat, pasi ato rrinë më shumë në shtëpi, etj.

- Bashkëbiseduesit e brezit të dytë, sipas tematikës, herë flisnin në standard, kur bëhej fjalë për shkollimin, punën, politikën, ndryshimet e vendit, etj., e herë binin në të folmen tiranase, sidomos kur flisnin për jetën e tyre shoqërore, familjen, të afërmit, kujtimet e fëmijërisë.

- Sa u përket bisedave të kryera me femrat e meshkujt e brezit të tretë, u vu re përdorim i gjerë i standardit i përzier me zhargonet shkollore, apo dhe me shumë fjalëve të huaja, kryesisht të teknologjive më të reja, të internetit, të mediave, anglicizmave. Ashtu siç dëgjohet shpesh nga të rinj të tjerë që kanë lindur e janë rritur në Tiranë, pavarësisht se mund të mos kenë origjinën e familjes nga Tirana, edhe tek ta kishte rëndom përdorim të formave: *ec mo, hajt mi, ça thu mo, u bo ky, tiron*, etj. Duhet theksuar gjithashtu se në këtë grup, në familjet ku të dy prindërit janë tiranas me origjinë, edhe fëmijët kanë

ruajtur shumë më tepër të folmet e prindërve; nëse është një nga prindërit, atëherë fëmija flet më pak, e kështu me radhë.³ Dallimet gjuhësore janë kushtëzuar përgjithësisht nga faktorë shoqërorë. Dhe në këtë rast, duket se arsyet e përdorimit apo jo të të folmes së Tiranës nuk janë thjesht gjuhësore, kulturore dhe psikologjike, por sidomos shoqërore.

Duket se mungesa e komunikimit të të folmes së Tiranës nga qytetarët e saj të rinj, që vijnë nga familje autoktone tiranase, do të çojë, jo larg në kohë, në një humbje graduale të saj.

E folmja e Tiranës nuk i ka shpëtuar dot fenomenit të madh e të pashmangshëm të globalizmit, trysnisë së jashtëzakonshme të të ardhurve heterogjenë të saj, ndikimit të standardit, zhvillimeve teknologjike etj. Në këtë kuptim, gjuha tiranase duket si më e prekura nga gjithë kjo atmosferë përfshirëse fenomenesh të reja shoqërore. E folmja e Tiranës sot paraqet karakter ruajtës vetëm sa i përket tingëllimeve të saj të veçanta fonetike, ndërkohë që janë zbehur tiparet specifike gramatikore të kësaj të folure gege. Ndërsa leksiku ‘tironas’ duket si një shfaqje që po i takon të shkuarës.

Nëse në të ardhmen e folmja e Tiranës do të shkojë drejt tkurrjes apo shuarjes së plotë, një mënyrë e mirë për ta ruajtur përgjithmonë atë, mund të ishte shkrimi i ndonjë vepre të sotme letrare apo i një gjinie tjetër në këtë të folme, si dokumente të rëndësishme për studimet e mëtejshme shkencore mbi gjuhën shqipe, dialektet, nëndialektet e të folmet e saj.

BIBLIOGRAFIA

- “KOHAnet”, 16.04.2013, “Prof. Seit Mancaku: Gjuha standarde i ka qëndruar kohës”,
A. Jubani (2012), *Fonetikë akustike*, Tiranë, f. 24.
B. Beci, *Gegërishtja veriore dhe grupimi i të folmeve të saj*, në “Studime Filologjike”, 1987/3, Tiranë, f. 63-65.
Blogu “Peizazhe të fjalës”, Ardian Vehbiu: “Teza të shkurtisura”,
E. Çabej (1979), Gazeta “Mësuesi”, “Për pastërtinë e gjuhës”, ribotuar në revistën “Gjuha jonë”, Nr. 1, 1981, f. 36-47.
Gazeta “Bota Sot”, 3 dhjetor 2011, Amik Kasoruho: “Përshkënditje rreth Bep Zorbës”.
Gazeta “Shqiptarja.com”, 5 shtator 2013, “Ardian Klosi: “Dialekti si strehë dhe si rezistencë nën shembullin e tironçes””.
Gj. Shkurtaj (2012), *Dialektet e shqipes*, Tiranë, f. 23.
<http://koha.net/arkiva/?page=1,5,142800>
<http://peizazhe.com/2013/03/29/teza-te-shkurtisura/#more-12370>
J. Gjinari (2008), *Dialektet e gjuhës shqipe*, në “Fjalor enciklopedik shqiptar”, I, Tiranë, f. 465.
J. Gjinari, *Sprovë për një ndarje dialektore të gjuhës shqipe*, në “Studime filologjike”, 1966/4, Tiranë, f. 108-110.
M. Çeliku, *Mbi grupimin e të folmeve të gegërishtes jugore dhe mbi disa tipare të tyre*, në “Studime filologjike”, 1968/1, Tiranë, f. 123-134.
Sh. Rrokaj (2013), *Çështje të gjuhës shqipe*, III, Tiranë, f. 56.

³ Shënim: Nuk janë vendosur të gjitha bashkëbisedimet për të mos rënë në përsëritje, por janë pasqyruar ato pjesë që janë më interesante për këtë punim nga ana gjuhësore.